



HENDEKU, KURRIKULA DHE ZBATUESHMËRIA E SAJ

“Hendeku, kurrikula, dhe zbatueshmëria e saj”

Ky Raport u hartua nga grupei monitorues i fëmijëve, “Respect Our Rights” (ROR)¹ në kuadër të projekteve “Qeverisja për të drejtat e fëmijës – Monitorimi i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës” që implementohet nga Organizata Syri i Vizonit (SiV) në partneritet më Save the Children (SCiK). Përbajtja e raportit është përgjegjësi e grupit ROR e nuk përfaqëson qëndrimet e SiV dhe SCiK.

¹Uebfaqja: <http://www.ror-rks.net/en/>

Facebook: https://www.facebook.com/Respect-Our-Right-ROR-873015802723279/?ref=br_rs

AKRONIME

AKF	Asambleja Komunale e Fëmijëve
IAP	Institucion i Avokatit të Popullit
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
KK	Korniza Kurrikulare
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë
OJQ	Organizata Jo- Qeveritare
ROR	Respect Our Rights
SCiK	Save the Children në Kosovë
SHMU	Shkolla Mesme Ulët
SHML	Shkolla Mesme Lartë
SiV	Syri i Vizonit

FALËNDERIME

Ky raport u hartua falë kontributit të grupit ROR, të personelit të SCiK dhe SiV, dhe pjesëmarrësve të shumtë të përfshirë në hulumtim.

Falënderojmë drejtorët, mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollave të mesme të ulëta (SHMU) dhe shkollave të mesme të lartë (SHML) për pjesëmarrjen në hulumtim përmes plotësimit të pyetësorëve si: SHFMU "Xhemajl Mustafa" dhe SHFMU "Faik Konica" në Prishtinë, SHFMU "Daut Bogujevci" në Fushë Kosovë, SHFMU "Musa Zajmi" dhe SHFMU "Rexhep Elmazi" në Gjilan, SHFMU "Xhemajl Kada" dhe SHFMU "Asdreni" në Pejë. Falënderojmë drejtorët, mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollave të mesme për pjesëmarrjen në hulumtim përmes plotësimit të pyetësorëve në: Gjimnazin "Sami Frashëri" në Prishtinë, gjimnazin "Hivzi Sylejmani" në Fushë Kosovë dhe gjimnazin "Bedri Pejani" në Pejë.

Falënderim i posaçëm shkon për anëtarët e Komisionit për Monitorimin e Teksteve shkollore dhe Kurrikulave të grupit ROR, që shprehën përkushtim gjatë gjithë kohës së hulumtimit. Një falënderim për gjithë Grupin ROR, zyrtarët e organizatës "Syri i Vizonit", veçanërisht Teuta Uka dhe Ardit Halilaj, si dhe zyrtarët e organizatës tjeter partnere "Save the Children", veçanërisht Donjeta Haliti dhe Blerim Murtezi përkrahjen e ofruar ndaj anëtarëve të Komisionit gjatë gjithë etapave të procesit të hulumtimit.

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	3
HYRJE	4
RRETH GRUPIT RESPECT OUR RIGHTS (ROR)	5
METODOLOGJIA	6
I. ANALIZA E TË DHËNAVE	7
I.1. PËR ORARIN MËSIMOR DHE KURRIKULËN	7
I.2. PËR TESTE VLERËSUESE.....	10
I.3. PËR LËNDËT ZGJEDHORE	12
I.4. PËR ORËT E KUJDESTARISË.....	14
2. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....	15
3. ANEKS	15
Aneks 1: Pyetësor i zhvilluar me nxënësit.....	18
Aneks 2; Pyetësor i zhvilluar me mesimdhënësit.....	24
Aneks 3: Pyetësor i zhvilluar me drejtorët.....	30

HYRJE

Raporti “Hendeku, kurrikula dhe zbatueshmëria e saj” është përpiluar dhe përgatitur nga anëtarët e Komisionit për Monitorimin e Teksteve shkollorë dhe Kurrikulave në kuadër të Grupit Respect Our Right (më tutje shkurtimisht ROR), i cili mbështetet nga organizatat OJQ ”Syri i Vizionit”, në Pejë (më poshtë SiV) dhe Save the Children, zyra në Kosovë (më poshtë SCiK) në kuadër të fushës së programit CRG (Qeverisja me të drejtat e fëmijëve).

Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovë²s (e rishikuar), gusht 2016, është dokument bazë i arsimit, më të cilin rregullohet sistemi i arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës. Në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar parashihet që qëllimet e arsimit tek të rinjtë/rejat të arrihen nëpërmjet zhvillimit të dijes, të shkathtësive, të qëndrimeve dhe të vlerave që i kërkon shoqëria demokratike. Kjo u mundëson të rinje të janë qytetarë aktivë dhe të përgjegjishëm, të përballen në mënyrë konstruktive me dallimet dhe sfidat si dhe të respektojnë të drejtat e tyre dhe të drejtat e të tjera.

Meqenëse parimet e Kornizës Kurrikulare dhe të sistemit të arsimit parauniversitar janë: gjithëpërfshirja, zhvillimi i kompetencave, mësimdhënia, dhe të nxënës e integruar dhe koherent/të ndërlidhur, autonomia dhe fleksibilitet në nivel shkolle dhe përgjegjësia dhe llogaridhënia, nga grupei ROR është menduar si tejet e rëndësishme hendeku që ka mes kurrikula dhe zbatimit të këtyre parimeve.

Me anë të këtij raporti, anëtarët e Grupit ROR të cilët i përkasin fushës së monitorimit të zbatimit të të drejtës fundamentale për edukim dhe arsimim (shkollim), prezantojnë të dhënat e dala në hulumtimin në mënyrë që institucionet përgjegjëse, gjegjësisht Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA), të janë të njoitura më gjërësisht me disa prej shumë sfidave të reformimit të sistemit arsimor në vend.

Qëllimi i raportit është prezantimi i të gjeturave për tematikat e hulumtuara siç janë:

- Informimi rrëth implementimit të kurrikulave arsimore në shkollë,
- realizimi ose jo i orës së kujdestarisë,
- matja e nivelit të ngarkesës së nxënësve gjatë kohës së testeve dhe ngarkesa e orarit mësimor.

Hulumtimi është kryer nga anëtarët e Komisionit për Monitorimin e Teksteve shkollorë dhe Kurrikulave përmes pyetësorëve të hartuar nga vet ata, me fokus grupet si: nxënës, mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave të mesme të ulëta dhe të mesme të larta të komunave: Prishtinë, Gjilan, Pejë dhe Fushë Kosovë. Fëmijët sjellin edhe rekomandimet që duhen marrë parasysh dhe sjellin para jush zérin e fëmijëve dhe situatën perceptuese të të rriturve që punojnë me fëmijë, respektivisht me nxënës, prandaj urojmë që me anë të këtij raporti të kontribuohet sadopak në rritjen e cilësisë së arsimit në vend.

²<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>

Përveç KK-së, për ta zbërthyer më tutje kurrikulën janë dokumente e tjera kurrikulare, si: Kurrikula Bërthamë për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (lindje–5 vjeç, për grupmoshat 0–3 dhe 3–5), Kurrikula Bërthamë për Arsimin Fillor, Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Ulët, Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë– gjimnaze, Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë- shkolla profesionale. Planet dhe programet lëndore nga klasa përgatitore deri në kl. XII, duke mbuluar të gjitha fushat /lëndët mësimore për secilën klasë.

RRETH GRUPIT RESPECT OUR RIGHTS (ROR)

Grupi ROR është grupi i parë në Kosovë i udhëhequr nga fëmijët, që bën monitorimin e zbatimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) dhe ligjeve në fuqi në Kosovë që për qëllim kanë sigurimin e mirëqenies së fëmijëve.

Grupi ROR është themeluar në vitin 2014 nga organizata jo-qeveritare SiV në partneritet me SCiK dhe përbëhet nga 24 anëtarë, të moshave 14-17 vjeç duke përfshirë edhe fëmijë me aftësi të kufizuara, të cilët i përkasin komunave të ndryshme të Kosovës dhe përkatësive të ndryshme etnike.

Grupi ROR realizon aktivitete që në vazhdimësi synojnë ngritjen e vetëdijesimit shoqëror për mirëqenien e fëmijëve, promovojnë gjendjen reale të fëmijëve në vend dhe avokojnë tek institucionet përgjegjëse në nivel komunal dhe nacional për përmirësimin e respektimit të të drejtave të fëmijëve dhe implementimin e të drejtave të tyre në praktikë. Ky grup ka një bashkëpunim të madh, para së gjithash, me fëmijët, Asambletë Komunale të Fëmijëve (AKF) në komuna të ndryshme, dhe me institucione të larta të vendit. Ndër aktivitetet më të rëndësishme të Grupit ROR përgjatë këtyre dy viteve të fundit (2017-2018) janë:

- Përpilimi i Analizës për Tekstet Shkollore, ku anëtarët e Grupit ROR kanë dalë me disa të gjetura që u prezantuan më pas para zyrtarëve të MASHT (2017);
- Kryesimi i seancës “Fëmijët udhëheqin Parlamentin” në Parlamentin e Kosovës për ndër të 20 Nëntorit- Ditës Universale të të Drejtave të Fëmijëve, me ç ‘rast u miratua Rezoluta për të Drejtat e Fëmijëve nga votat e fëmijëve të ulur në ulëset e deputetëve (poashtu në këtë ngjarje, disa anëtarë të grupit u takuan me Kryeministrin dhe kryeparlamentarin e Republikës së Kosovës dhe ia dorëzuan Rezolutën e miratuar dhe diskutuan më gjërësisht me udhëheqësit e vendit për çështjen e fëmijëve në vend) (2017);
- Arritja e marrëveshjes së bashkëpunimit me Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) dhe zhvillimi i planit vjetor të bashkëpunimit mes IAP dhe ROR (2018).
- Organizimi i javës “Çdo ditë është I Qershori”, për të shënuar I Qershori – Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve (2018).
- Zëri dhe pikëpamjet e tyre janë dëgjuar dhe inkorporuar në Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Fëmijëve, në takim e zhvilluar me I Qershori nga Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Kryeministri i Kosovës (2017 - 2018).

Struktura e Grupit ROR përbëhet nga:

Sekretariati - si organi më i lartë i grupit, me kryetarin. Komisionet me detyra specifike, si dhe anëtarët vullnetarë të grupit të cilët janë mbi moshën 18 vjeçare. Komisionet janë:

- Komisioni për Monitorimin e Teksteve Shkollore dhe Kurrikulave në Shkollë,
- Komisioni për Buxhetim,
- Komisioni për Monitorimin e Planit të Punës së Grupit ROR,
- Komisioni për Promovimin e Grupit ROR.

Në Grupin ROR vërehet bashkëpunimi i ngushtë dhe funksionimi i një grupei të mirëfilltë ku vendimet mbi zhvillimin e aktiviteteve apo edhe bashkëpjesëmarrjes si përfaqësues të fëmijëve merren përmes diskutimeve dhe votohet në mënyrë demokratike ku të gjithë anëtarët kanë të drejtë vote.

METODOLOGJIA

Komisioni për Monitorimin e Teksteve shkolllore dhe kurrikulave janë përgjegjës për zhvillimin e këtij raporti me anëtarët: Trina Hoti (Kryesuese e Komisionit), Fleta Mujaj, Valëza Miftari, Orines Gashi, Redona Syla, dhe Lejla Koliç, ndërsa mentorë (anëtarë vullnetarë të ROR-it) janë: Lekë Morina dhe Shaqir Maliqi.

Fëmijët e grupit “ROR” kryen një studim sipërfaqësor me fokus në funksionimin dhe zbatimin e kurrikulës se cilës i nënshtronhet arsimi parauniversitar në Kosovë. Të dhënat e raportit janë rezultat i pyetësorëve të zhvilluar gjatë fundit të vitit shkollor 2017/2018 me nxënësit e SHMU dhe të SHML, drejtorët dhe mësimdhënësë të shkollave përkatëse.

Në mënyrë të rastësishme u zgjodhën 4 komuna (Prishtinë, Fushë Kosovë, Pejë dhe Gjilan) në të cilat u zhvilluan pyetësorët. Për secilën komunë u listuan SHMU dhe të SHML dhe u përzgjodhën nga dy SHMU dhe dy SHML gjithashtu në mënyrë të rastësishme, por të cilat ushtrojnë zbatimin e kurrikulave të reja, duke formuar kështu hartën e shkollave në të cilën do të zhvilloheshin pyetësorët. Pjesëmarrësit ishin nga klasat 6-8 dhe 10-11 dhe përzgjedha e nxënësve, mësimdhënësve dhe drejtorëve të anketuar në 8 shkollat në 4 komunat, u bë në mënyrë krejt të rastësishme, me kuotë të bazuar në barazi gjinore.

Pjetësorëve u janë përgjigjur gjithsej 146 nxënës (shih aneksin I: për pyetësorin e zhvilluar për nxënës); 22 mësimdhënës (aneksi 2: për pyetësorin e zhvilluar më mësimdhënës); dhe 7 drejtorë (aneksi 3: për pyetësorin e zhvilluar më drejtorët). Një ndër problemet gjatë zhvillimit të punës dhe realizimit të pyetësorëve ka qenë mosgatishmëria e drejtorëve të shkollave që të marrin pjesë në plotësimin e pyetësorëve si dhe koha e shkurtër për plotësimin e pyetësorëve pasi që të njëjtë janë zhvilluar në fund të vitit shkollor (qershori), duke e pamundësuar kështu pjesëmarrjen më të madhe në pyetësor.

Me qëllim të mbrojtjes së identitetit të secilit prej respondentëve dhe për të siguruar përgjigje sa më konkrete dhe reale, pyetësorët u plotësuan në mënyrë anonime nga secili pjesëmarrës.

Temat nga të cilat janë formuluar pyetësorët kanë dalë si rrjedhojë e diskutimeve të bëra nga anëtarët e Komisionit për Monitorimin e Teksteve shkolllore dhe Kurrikulave, duke i përzgjedhur disa prej shumë çështjeve sfiduese të implementimit të kurrikulave mësimore në shkollë. Pas identifikimit të temave nga anëtaret e Komisionit dhe organizatave drejtuese të grupit të fëmijëve, u bë përcaktimi i indikatorëve nga të cilët varet rëndësia e temës dhe e informacionit që do të fitohet, kështu u hartua drafti i pyetësorit që do të përdorej për anketim.

Në këtë draft u përmblodhën gjithsej 4 tema:

1. Orari mësimor dhe kurrikula;
2. Testet vlerësuese;
3. Lëndët zgjedhore; dhe
4. Ora e kujdestarisë

Secila temë përmban mesatarisht 5 pyetje (kryesisht pyetje të mbyllura) si dhe aneksin (hapësirën e mjaftueshme që respondentët të shtojnë mendimet e tyre shtesë rreth temës).

I tërë procesi i përpilimit të metodologjisë, pyetësorëve dhe raportit ka zgjatur rreth 6 javë. Pyetësorët janë shpërndarë nga anëtarët e grupit “ROR” me ndihmën e organizatave drejtuese.

I. ANALIZA E TË DHËNAVE


Gjatë fundit të vitit shkollor 2017- 2018, anëtarët e Komisionit për Monitorimin e Teksteve shkolllore dhe Kurrikulave të grüp ROR, me mbështetjen e SiV dhe SCiK, përmes pyetësorëve (shih aneks I, 2, 3) mblodhën mendimet e nxënësve, mësimdhënësve dhe drejtoreve të shkollave përkatëse, sa i përket funksionimit dhe zbatimit të kurrikulës në shkollat e nivelit parauniversitar në Kosovë.

Vjelja e mendimeve në 7 SHFMU si dhe 1 SHML u mundësua përmes anketimit të 146 nxënësve nga të cilët 49.32% vajza, ndërsa 48.63% djem. 22 mësimdhënës prej të cilëve 68.18% gra e 27.27% burra, si dhe 7 drejtore, secili prej tyre përfaqësues i nxënësve me një mesatare prej rreth 1196 nxënës për shkollë.

I.I. PËR ORARIN MËSIMOR DHE KURRIKULËN

Lidhur me çështjen nëse orari i ditës së hënë dhe ditës së premte duhet të jetë më pak i ngarkuar, rreth 72% e nxënësve të anketuar e pohojnë atë me “po”, kundrejt 28% e tyre që e mohojnë atë me “jo”.

Pjetjes së njëjtë i janë përgjigjur edhe mësimdhënësit dhe drejtoret, ku 86% e mësimdhënësve të anketuar e pohojnë atë me “po” dhe 87% e drejtoreve të anketuar, kundrejt 14% e mësimdhënësve dhe 13% e drejtoreve të cilët e mohojnë atë me “jo”.




Graf. I: Nëse orari i ditës së hënë dhe ditës së premte duhet të jetë më pak i ngarkuar sipas nxënësve mësimdhënësve dhe drejtoreve

Informimi

Lidhur me çështjen se a janë dhe sa janë të informuar nxënësit për kurrikulën, vetëm 3.42% janë përgjigjur se nuk janë të informuar fare, ndërkaq pjesa tjetër e të nxënësve të anketuar janë përgjigjur se janë të informuar plotësisht apo pjesërisht për kurrikulën.

Pasi që shumica e nxënësve kanë deklaruar se kanë informata (qoftë të pjesshme apo të plota) për kurrikulën e re, nga përgjigjet e pyetjes së “A ju nevojiten informata shtesë rreth kësaj kurrikule”, ata janë përgjigjur që ju duhet ende informata qoftë të pjesshme 24%, të plota 41%, përkundër 35% e nxënësve që kanë kërkuar ende informata shtesë rreth kurrikulës.



Graf. 2: A ju nevojiten nxënësve informata shtesë rreth kurrikuës

Ndërkaq, rreth mënyrës se si janë informuar ata, del se: 145 nga 146 e të anketuarve janë përgjigjur në pyetje ose 93.16% e nxënësve janë informuar nga mësimdhënësit, kujdestari apo drejtoria, ndërsa 6.16% kanë deklaruar se janë informuar nga bashkëmoshatarët, mediat apo nga burime të tjera.

Të njëjtës pyetje i janë përgjigjur edhe 20 nga 22 mësimdhënësit e anketuar duke zgjedhur dy apo më shumë përgjigje, ku 77.27% e tyre kanë deklaruar se janë informuar nga MASHT-i, 27.27% janë informuar nga drejtoria e shkollës, 4.55% nga Këshilli i Mësimdhënësve, ndërkaq pjesa e mbetur ose 4.55% janë informuar nga mediat.

Edhe pse shumica nga mësimdhënësit kanë deklaruar se janë të informuar nga burime të ndryshme rreth zbatimit të kurrikulës, duket se shumicën e informacioneve të tyre i kanë marrë gjatë trajnimit mbi zbatimin e kurrikulës, ku vetëm një respondent ka deklaruar se ende nuk e ka përfunduar trajnim për kurrikulë.

Zbatimi i kurrikulës


Duke konsideruar dhe pasur parasysh rëndësinë e kurrikulës shkollore, zbatueshmérinë e saj dhe ndikimin e saj në nivelin edukativo-arsimor në një shtet, përgjigje rreth kësaj çështje kemi marrë edhe nga drejtorët dhe mësimdhënësit e anketuar, ku 100% e drejtorëve të anketuar kanë vlerësuar se zbatimi i kurrikulës është i dobishëm për nxënësit e tyre. Përkundër përgjigjes së drejtorëve, vetëm 9.09% të mësimdhënësve të cilët kurrikulen e kanë konsideruar si më pak të rëndësishme, ndërsa pjesa tjetër kanë konsideruar se zbatueshmëria e kurrikulës është më efektive dhe praktike për procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Në anën tjetër nxënësit kanë vlerësuar shkollat e tyre dhe mësimdhënësit e tyre, duke e matur masën e zbatimit të kurrikulës së re në shkollën e tyre dhe përgjatë orëve mësimore. 122 nxënës apo 83.56% e nxënësve kanë deklaruar se kjo kurrikulë zbatohet në shkollën e tyre, përkundër 20 nxënës që përbëjnë 13.70% të anketuarve kanë deklaruar se kurrikula zbatohet pak apo aspak në shkollën e tyre, si dhe një përqindje e vogël e nxënësve nuk kanë pranuar të përgjigjen në këtë pyetje.

Kurrikula e re e Kosovës, "Kurrikula Bërrhamë" e nxjerrë nga MASHT në gusht të vitit 2016, nxitë nxënësit dhe mësimdhënësit që të përdorin metodat më bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies, përfshirë këtu punën në grup, angazhimin e secilit nxënës në procesin mësimor, krijimin e përvojës edukative për ambientim/përshtatje në një formë të sistemuar të të nxënët nëpërmjet lojës-punës- mësimit, realizimin e procesit edukativo-mësimor bëhet në mënyrë të integruar, i ndërlidhur me punën dhe jetën e përditshme të fëmijëve.

Shfrytëzimi i mjeteve alternative të mësimit


Duke marrë parasysh se interneti është pjesë e jetës së përditshme të fëmijëve, grupi ROR në këta pyetësorë ka parashtruar edhe çështjen e shfrytëzimit të burimeve alternative, siç është interneti, ku nëpërmjet pyetjes se sa herë mbahet ora mësimore duke shfrytëzuar këto burime, rreth 24.65% e nxënësve respondentë kanë pohuar me këtë përqindje nga niveli “gjithmonë” deri në nivelin “mesatarisht”. Të njëjtës pyetje me të njëjtat nivele i janë përgjigjur edhe mësimdhënësit, ku në këtë nivel janë deklaruar 31.82%. Ndërkaq 73.97% nxënësve kanë deklaruar me këtë përqindje nga niveli “asnjeherë” deri në nivelin “ndonjëherë”. Në të njëjtat nivele i janë përgjigjur edhe mësimdhënësit, ku në këtë nivel janë deklaruar 68.18%.



Graf. 3: Sa herë mbahen orët mësimore duke shfrytëzuar burimet alternative

Por, edhe shfrytëzimi i mjeteve alternative të mësimit, ndonjëherë shkakton edhe probleme dhe konfuzione tek mësimdhënësit dhe nxënësit, për shkak se të dhënat e gjitura në libra dhe ato në internet mund të jenë të ndryshme. Rreth këtij problemi janë prononcuar 143 nxënës, ku në nivelin “ndonjëherë” janë përgjigjur 62.33%, në nivelin “jo” janë përgjigjur 23.29%, ndërkaq në nivelin “shpesh” janë përgjigjur 12.33%.

Në të njëjtën pyetje me të njëjtat nivele janë përgjigjur edhe mësimdhënësit. Në nivelin “ndonjëherë” janë deklaruar 81.82% e tyre, në nivelin “rrallë” u deklaruan 13.64%, ndërkaq në nivelin “shpesh” u deklaruan 4.55%.



Graf 4: A hasin në raste kur burimet alternative/internet bien ndesh me literaturën shkollore

1.2. TESTET VLERËSUESE BREND A DITËS

Në vazhdën e çështjeve të përfshira në hulumtimi është edhe çështja e vlerësimit të nxënësve dhe testeve vlerësuese, të cilat nga Grupi ROR janë konsideruar si tema të cila nevojitet të ketë të dhëna për vlerësimin e nxënësve sipas kurrikulës, e sidomos aspektin e nivelit të stresit tek nxënësit dhe numrit të madh ose jo të mbajtjes së testeve vlerësuese brenda një dite.

Vlerësimi i nxënësve

Sipas kurrikulës qëllimi kryesor i vlerësimit të nxënësve është mbështetja e të nxënësit të nxënësve. Sipas vlerësimit të brendshëm, nxënësit vlerësohen me: vlerësim të vazhdueshëm, përbledhës dhe për shkallë.

Bazuar në Udhëzim Administrativ (MASHT), nr. 08/2018³, vlerësimi i vazhdueshëm realizohet nëpërmjet vlerësimit formativ dhe vlerësimit përbledhës. Nota e vlerësimit përbledhës formohet prej dy vlerësimeve përbledhëse nga VPI (60%) dhe VP2 (40%). Vlerësimi përbledhës i realizohet përmes instrumenteve si: evidenca e angazhimit në klasë, detyrat e shtëpisë, kuize, debate, prezantime me gojë, esetë, testet, etj., ndërsa vlerësimi përbledhës 2 harmonizohet sipas planit të shkollës.

Grupi ROR ka parashtruar pyetjen se a vlerësohen nxënësit sipas mënyrës së vlerësimit përbledhës të përcaktuar me kurrikulë, përgjigjet e mësimdhënësve dhe të nxënësve kanë dalë pothuajse të njëjtë, i cili është një indikator i mirë për të dëshmuar pasqyrën reale të gjendjes.

Një përqindje e konsiderueshme e nxënësve të anketuar (39.04%) kanë deklaruar se kjo metodë e vlerësimit zbatohet në të gjitha lëndët mësimore, 45.89% kanë thënë se ajo zbatohet në shumicën e lëndëve mësimore, ndërkaq (14.38%) janë deklaruar në nivelin “disa lëndë mësimore/asnjë lëndë mësimore”. Të njëjtës pyetje i janë përgjigjur pozitivisht edhe mësimdhënësit, ku 77.27% e tyre kanë thënë se këto metoda vlerësimi i zbatojnë në të gjitha klasat, 13.64% e tyre kanë deklaruar se i zbatojnë ato në shumicën e rasteve apo në disa raste/klasa, ndërkaq në anën tjetër 4.55% e tyre janë përgjigjur negativisht, duke u shprehur se nuk i zbatojnë ato në asnjë rast.

Testet vlerësues brenda ditës


Se sa shihet e arsyeshme që të mbahen më shumë se një test vlerësues nga nxënësit brenda një dite, mazhoranca e mësimdhënësve të anketuar (68.18%) kanë deklaruar se nuk e shohin të arsyeshme këtë dukuri, rreth 22.73% kanë thënë se ndonjëherë e shohin si të arsyeshme që të ndodh kjo dukuri, ndërkaq vetëm 4.55% janë deklaruar me “po”, që nënkupton se e shohin të arsyeshme këtë dukuri.

Edhe nxënësit e anketuar janë përgjigjur rreth të njëjtës çështje, prej të cilëve pasqyrohet gjendja konkrete rreth kësaj dukurie. Në pyetjen se a ka ndodhur ndonjëherë në shkollë të keni më shumë se një test brenda një dite, 82.19% e nxënësve të anketuar janë përgjigjur me “po”, duke pohuar kështu raste evidente të kësaj dukurie, në anën tjetër 10.27% e tyre janë përgjigjur me “ndonjëherë” duke dëshmuar që raste të tillë ekzistojnë, ndërkaq vetëm 6.85% e tyre kanë dhënë përgjigje negative, duke thënë se nuk kanë hasur vetë në raste të tillë.

Aq më tepër ata i janë përgjigjur edhe pyetjes se sa është numri më i madh i testeve të mbajtura brenda një dite, nga numri 1-3 teste janë përgjigjur 92.46% e respondentëve, gjë që tregon se kjo dukuri jo vetëm që është e pranishme, por është edhe mjaft shqetësuese. Ndërsa, 6.85% kanë rastisur të mbajnë më shumë se 3 teste brenda një dite.

Përndryshe, drejtoret e anketuar i janë përgjigjur pyetjes se a mbajnë nxënësit e shkollës suaj më shumë se një test vlerësues brenda një dite, 71.43% e tyre janë përgjigjur me “po”, duke pohuar kështu drejtpërdrejt rastet e tillë, ndërkaq 28.57% e tyre janë përgjigjur me “jo” duke i mohuar kështu këto raste.

³https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/08/ua-nr-08-2016-per-vleresimin-e-nxeneseve_1.pdf



Graf 5: Mbajtja e një testi brenda një dite

Para hartimit të pyetësorit, është evidentuar nga grupi punues se kjo çështje është mjaft evidente në shkollat e tyre dhe duke tentuar gjithmonë identifikimin e arsysë së problemit dhe gjetjes së një zgjidhjeje racionale, mësimdhënësit janë pyetur se a koordinohen me kolegët e tyre në mënyrë që nxënësit të mos kenë më shumë se një test brenda ditës, përgjigjet e tyre kanë qenë pozitive, duke u shprehur me "po", që tregon se ata koordinohen para se të vodosin për testet e nxënësve, ndërkaq vetëm 22.73% kanë kundërshtuar këtë deklarim, duke thënë se ndonjéherë koordinohen apo nuk koordinohen fare për mbajtjen e testeve.

Por, këto të dhëna nuk arsyetohen dhe nuk dalin në përputhje me nxënësve të cilët në masë të madhe kanë deklaruar se ka raste të shpeshta kur mbahen më shumë se një test brenda ditës si dhe drejtorët të cilët pohojnë se mësimdhënësit kanë udhëzime të qarta për mënyrën e organizimit të testeve vlerësuese në mënyrë që nxënësit të mos ngarkohen psiqikisht dhe të performojnë sa më mirë.


Stresi tek nxënësit nga testet vlerësuese

Prania e më shumë se një testi brenda një dite shkakton stres tek nxënësit, i cili ndikon në uljen e performancës së tyre, KK-ja parashev kompetencën e të mësuarit ("Nxénés i suksesshëm") dhe kompetencës personale ("individ i shëndoshë")⁴. Për një "nxénés të suksesshëm" i gjithë stafi i shkollës angazhohet të kultivojë/nxisë vazhdimiçht këershërinë e natyrshme të nxënësve dhe interesimin për të nxënë si dhe të zhvillojë kompetencën për të mësuar(nxënë). Një "Nxénés i shëndetshëm" inkudrohet dhe përgatitet për në jetën familjare, shoqërore dhe të punës.

Nxënësit pjesëmarrës në këtë anketë i janë përgjigjur pyetjes se sa ndjehen të stresuar gjatë kohës së testeve, ku 84.24% kanë gjetur vetën në nivelin "mesatarisht/ shumë/ jashtëzakonisht shumë", gjë që tregon se përpos problemeve të lartpërmendura, kjo dukuri shkakton edhe probleme psikike tek nxënësit. Ndërkaq një pjesë e vogël prej 15.06% kanë gjetur vetën në nivelet "pak/ aspak", duke dëshmuar se nuk gjejnë vështirësi edhe në situata të tilla.

Pyetjes "a mendoni se mbajtja e më shumë se një testi brenda një dite shkakton ngarkesë psikike dhe stres tek nxënësit", nga niveli "mesatarisht deri tek ai jashtëzakonisht shumë" janë përgjigjur pozitivisht rreth 81.82% e mësimdhënësve si dhe 85.72% e drejtorëve, përkundër 13.64% e mësimdhënësve që janë përgjigjur negativisht me përgjigjen "pak", si dhe 14.29% e drejtorëve që kanë dhënë të njëjtën përgjigje.

⁴<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>



Graf 6: Mbajtja e më shumë se një testi brenda dites ngarkesë psikike dhe stres tek nxënësit

I.3. PËR LËNDËT ZGJEDHORE

Sipas Kurrikulave lëndore/programet mësimore⁵ të klasa të SHFMU dhe SHML (klasa I deri në XIII), të cilat mbulojnë të gjitha fushat/lëndët mësimore për secilën klasë, e si dokumente të cilat e zbërthejnë KK, mësim zgjedhor quhet sepse nxënësit e zgjedhin sipas dëshirës, dhuntisë, nevojës apo interesit. Lënda, kursi apo veprimtaria për mësimin zgjedhor mund të sugjerohet nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ose në bazë të kërkesës së nxënësve, prindërve, arsimtarëve, apo kujtdo tjetër nga komuniteti.

Për lëndën, kursin apo veprimtarinë duhet të deklarohen më se paku 15 (pesëmbëdhjetë) nxënës (në qoftë se klasa ka më shumë se një paralele) e në qoftë se klasa ka vetëm një paralel, atëherë është e nevojshme të deklarohen gjysma e paraleles, në mënyrë që të mund të organizohet mësimi zgjedhor. Për mësimin zgjedhor, në bazë të kërkesave të të interesuarve, vendosin organet profesionale të shkollës në bashkëpunim më Zyrën Rajonale të Arsimit para fillimit të vitit shkollor. Për mënyrën e deklarimit të nxënësve, të prindërve apo të të interesuarve të tjere dhe kohën kur ata e bëjnë këtë, vendosin organet e shkollës, por gjithsesi e tërë procedura duhet të kryhet para fillimit të vitit shkollor.

Përzgjedhja e lëndëve zgjedhore


Lidhur me përzgjedhjen e lëndëve zgjedhore kemi parashtruar disa pyetje për drejtorë, mësimdhënës dhe nxënës. Meqenëse lëndën zgjedhore nxënësit duhet të zgjedhin sipas dëshirës, dhuntisë dhe interesave të tyre, lënda zgjedhore duhet të jetë lënda më e dashur për ta. Për të parë se ku qëndron lënda zgjedhore në mesin e lëndëve tjera dhe sa atraktive është ajo për nxënësit, kemi parashtruar pyetjen: “Nga kush bëhet përzgjedhja e lëndëve zgjedhore?”, kanë dalë këto rezultate:

Nxënësit deklarojnë se ato kryesisht i zgjedhin mësimdhënësit/drejtori me përqindje më të madhe 36.99%, ndërsa vetëm 6.85% kanë thënë se i zgjedhin ata vetë personalisht.

Mësimdhënësit, respektivisht 45.45% prej tyre kanë thënë se lëndët zgjedhore i përzgjedh Këshilli i mësimdhënësve, ndërkundje një numër i vogël i tyre deklarojnë se ato i zgjedh MASHT-i (4.55%).

Drejtorët duke zgjedhur dy apo më shumë përgjigje, 57.14% e tyre deklaruan se ato i përzgjedh Këshilli i mësimdhënësve apo drejtoritë komunale të arsimit, përkundër një numër i vogël i tyre 14.29% thonë se MASHT i përzgjedh ato.

⁵<https://masht.rks-gov.net/korniza-e-kurrikules-e-arsimit-parauniversitar>




Graf 7: Kush e bën përgjedhjen e lëndëve zgjedhore

Nga përgjigjet e dhëna në pyetjet paraprake është parë që nxënësve nuk iu jepet mundësia që të përgjedhin vetë lëndët zgjedhore, dhe këtë më së miri dëshmon edhe përgjigjja në këtë pyetje drejtuar mësimdhënësve, ku 54.55% e tyre janë përgjigjur me "jo" duke dëshmuar se nxënësit nuk kanë rol vendimmarrës në përgjedhjen e lëndëve zgjedhore dhe njëkohësisht në procesin në të cilin ata duhet të marrin pjesë dhe të janë vendimmarrës. Ndërsa vetëm 36.36% e tyre kanë pohuar se nxënësit marrin pjesë në këtë proces.

Por, duke marrë parasysh që fëmijët/nxënësit nuk marrin drejtpërdrejt pjesë në vendimmarrje rrëth lëndëve zgjedhore që iu ofrohen, mësimdhënësit dhe drejtorët nëpërmjet dy a më shumë përgjigje janë përgjigjur në pyetjen se "në cilën formë/mënyrë është përdorur përmes marrë parasysh opinionet dhe interesimet e tyre gjatë përgjedhjes", ku 18.18% e mësimdhënësve kanë thënë se është zhvilluar një anketë në nivel shkolle, ndërkaq 57.14% e drejtorëve kanë dhënë të njëjtën përgjigje. Po ashtu, 13.64% e mësimdhënësve kanë thënë se janë zhvilluar takime lidhur me këtë temë, përkundër drejtorëve të cilët rrëth 71.43% e tyre e kanë dhënë të njëjtën përgjigje. Ndërkaq, se a është pyetur Këshilli i nxënësve përgjedhje të lëndëve zgjedhore, vetëm 13.64% e mësimdhënësve kanë pohuar të njëjtën.

Si vlerësohen nxënësit në lëndët zgjedhore

Lidhur me pyetjen se si vlerësohen nxënësit në lëndët zgjedhore, sipas rezultateve të dala nga nxënësit, mësimdhënësit dhe drejtoret, del se nga vlerësimi me test/shkrim, vlerësimi me gojë, nga aktivitetet/pjesëmarrja aktive në orë dhe kombinimi i të gjitha përgjigjeve, për drejtoren, mësimdhënës dhe nxënës kanë dalë këto rezultate:




Graf 7: Vlerësimi i nxënësve në lëndët zgjedhore

1.4. PËR ORËT E KUJDESTARISË

Në pyetjen lidhur me orët e kujdestarisë, se a mbahen ato, 73.29% e nxënësve të anketuar kanë pohuar se ato mbahen, qoftë gjithmonë apo edhe nganjëherë, ndërkaq një përqindje prej 25.34% kanë deklaruar se ato i mbajnë rrallë ose asnjëherë. Pyetjes së njëjtë i janë përgjigjur edhe 22 mësimdhënës të anketuar, prej të cilëve 19 prej tyre janë kujdestarë klasash. Nga përgjigjet e tyre del se 63.63% e tyre thonë se orët e kujdestarisë i mbajnë, qoftë gjithmonë apo nganjëherë, ndërsa 22.73% e tyre thonë se ato i mbajnë rrallë ose asnjëherë.

Nga rezultatet e mësipërme del se orët e kujdestarisë mbahen rregullisht dhe të njëjtit i shohin orët e kujdestarisë si shumë të nevojshme. Nga mësimdhënësit, 90.91% e shohin orën e kujdestarisë si të rendësishme, ndërkaq 9.09% e shohin si më pak të rendësishme. Nxënësit, 142 nga 146 të anketuarve, rrith 94.52% e tyre vlerësojnë si të rendësishme mbajtjen e saj, ndërsa 2.74% e vlerësojnë si jo të rendësishme. Në anën tjetër, 85.71% e drejtoreve e shohin si të nevojshme mbajtjen e orëve të kujdestarisë, përkundër 14.29% të tyre që e shohin si të parëndësishme.



Graf 7: Nevoja për mbajtjen e orës së kujdestarisë

2. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Sipas të dalave nga pyetësorët e realizuar me nxënës, mësimdhënës dhe drejtor të shkollave të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, Komisioni për Monitorimin e Teksteve shkollore dhe kurrikulës lidhur me zbatimin e kurrikulës së cilës i nënshtrohet arsimi parauniversitar në Kosovë, ka dal me disa rekomandime dhe konkluzione.

- MASHT së bashku me Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe mësimdhënësit duhet të punojnë që nxënësit të jenë më të informuar në lidhje me kurrikulat shkollore me anë të së cilave zhvillohet procesi mësimor dhe bëhet vlerësimi i njohurive të fituara të tyre.
Shkolla duhet të krijojë mekanizma të cilat mundësojnë që nxënësit, mësimdhënësit, prindërit dhe të interesuarit e tjerë të deklarohen për pjesën e mësimit zgjedhor, për të parë se cilat janë nevojat dhe interesimet për mësimin zgjedhor ku do t'i përfshijë të gjitha palët e interesit, shkolla mund të organizojë takime, debate, apo edhe hulumtime (intervista, pyetësorë).
- Kërkohet nga MASHT që të bëhet korrigjimi i teksteve mësimore së paku çdo 5 vite në mënyrë që njohuritë e fituara nga librat shkollore të jenë të sakta dhe të përkojnë me zbulimet dhe hulumtimet shkençore të kohëve të fundit. Në këtë mënyrë nuk do të shkaktojnë konfuzion tek nxënësit kur bëhet ndërlidhja e procesit mësimor në mjetet e teknologjisë moderne
- Me interes të veçantë është përfshirja e fëmijëve (nxënësve) në procesin e vlerësimit të teksteve dhe mjeteve mësimore. Kjo do të duhej të merrej parasysh dhe të definohej ligjërisht në mënyrë që të bëhet në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse. Kjo nënkupton gjithashtu edhe përbushjen e një të drejtë elementare që ka të bëjë me të drejtat e fëmijëve dhe pjesëmarrjen në çështjet që kanë të bëjnë me vet fëmijët.
- Drejtoritë e shkollave së bashku me mësimdhënësit duhet të koordinojnë orarin e provimeve/testeve në mënyrë që të mos mbahen dy apo më shumë teste në të njëjtën ditë, pasi që përveç ngarkesës së tepërt shkaktojnë edhe stres tek nxënësit.

3. ANEKS

Aneks 1: Pyetësor i zhvilluar me nxënësit

Aneks 2; Pyetësor i zhvilluar me mësimdhënësit

Aneks 3: Pyetësor i zhvilluar me drejtorët

PYETËSOR PËR NXËNËS

Mbi Grupin ROR:

Grupi Respect Our Right (ROR) është grupei i parë kombëtar në nivel vendi, i themeluar në vitin 2014, që bën monitorimin e zbatimit të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë dhe legjislacionit nacional, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.

Grupi ROR është i përbërë nga 24 fëmijë nga komunat e ndryshme te Kosovës, të moshave 14-17 vjeç, duke përfshirë fëmijë nga komunitetet dhe me aftësi të kufizuara dhe përkrahët nga Save the Children zyra në Kosovë (më tutje SCiK), dhe organizata joqeveritare Syri i Vizonit (më tutje SiV).

Përmes aktiviteteve lobuese, grupei ROR fuqizon zërin e fëmijëve në nivel vendi dhe avokon drejtpërsëdrejti tek institucionet përgjegjëse të cilat kanë për mandate mbrojtjen dhe qeverisjen me të drejtat e fëmijëve, për çështjet të cilat ndikojnë në jetën dhe mirëqenien e fëmijëve.

Qëllimi i Studimi:

Grupi monitorues ROR nëpërmjet këtij pyetësori ka për qëllim të krijojë një pasqyrë të mbarëvajtjes së procesit mësimor që zbaton kurrikulat e reja mësimore dhe të çështjeve të si: përzgjedhja e lëndës zgjedhore, mbajtja e më shumë se një testi brenda ditës, mbajtja e orës së kujdestarisë apo rëndësia e kthimit të orës së kujdestarisë, marrja e informatave shtesë mbi kurrikulat.

Pas realizimit të këtij hulumtimi, ne si grup i fëmijëve ROR me ndihmën e dy organizataave SiV dhe SCiK do të përpilojmë një raport më të dalurat nga pyetësorët ku më pas këto të dala do të ju prezantohen institucioneve përgjegjëse në nivel lokal dhe nacional.

Duke u përgjigjur në këtë pyetësor ju jeni duke kontribuar në gjetjen konkrete të ngecjeve në procesin e arsimit.

Të dhënat e pyetësorit do të trajtohen si anonime dhe të fshehta dhe do të përdoren vetëm për qëllim të këtij pyetësori.

Të faleminderit!

PAK PËR TY

1. Në cilën shkollë shkon? _____
2. Në cilin fshat apo qytet është shkolla jote? _____
3. Në cilën klasë i vijon mësimet? _____
4. Çfarë ka qenë suksesi juaj akademik ne vitin e fundit

Shkëlqyeshëm

Mirë/Shumë mirë

Dobët

5. Cila është përkatesia jote etnike? _____
6. Sa vjeç jeni? _____
7. Cila është gjinia jote?

Vajzë

Djalë

8. A ke ndonjë aftësi të kufizuar?

- Aftësi të kufizuara fizike
- Aftësi të kufizuara të dëgjimit/shurdhim
- Aftësi të kufizuara të të parit/verbim
- Aftësi të kufizuara të të nxënët
- Dislekzi
- Dispraksi
- Çrregullim të spektrit të autizmit
- Sindromën Down
- Çrregullimi të të folurit
- Gjendje mjekësore
- Tjetër (të lutem shëno) _____.

PËR ORARIN MËSIMOR DHE KURRIKULEN

1. Sa është i ngarkuar orari mësimor në ditën e hënë dhe në ditën e premte?

- Aspak
- Pak
- Mesatarisht
- Shumë
- Jashtëzakonisht shumë

2. A mendon që orari i ditës së hënë dhe ditës së premte duhet të jetë më pak i ngarkuar?

- Po, mendoj që është e nevojshme
- Po, do të ishte më pak stresuese për mua
- Jo, nuk është e nevojshme

3. A jeni të informuar për kurrikulën në shkollën tuaj?

- Po
- Jo
- Pjesërisht

4. Nëse "po" apo "pjesërisht", si jeni informuar për kurrikulën në shkollën tuaj?

- Nga mësimdhënësit
- Nga kujdestari
- Nga drejtoria
- Nga Këshilli i nxënësve
- Nga bashkëmoshatarët
- Nga mediat elektronike dhe të shkruara, nga interneti dhe rrjetet sociale
- Tjetër (të lutem shëno) _____

5. Sa jeni i/e informuar për kurrikulën që synojnë rritjen e cilësisë në shkollën tuaj?

- Aspak
- Pak
- Mjaftueshmë
- Shumë
- Jashtëzakonisht shumë

6. A mendoni që keni nevojë për informata shtesë mbi kurrikulën në shkollën tuaj?

- Po
- Jo
- Pjesërisht

7. A mendoni se zbatohet kurrikula në shkollën tuaj?

- Aspak
- Pak
- Mjaftueshëm
- Shumë
- Jashtëzakonisht shumë

8. Sa herë mbani orë mësimore duke shfrytëzuar burimet alternative, si p.sh internetin?

- Asnjëherë
- Rrallë
- Ndonjëherë
- Mesatarisht
- Shpesh
- Gjithmonë

9. A hasni në raste kur burimet e internetit bien ndesh me literaturë shkollore?

- Ndonjëherë
- Shpesh
- Jo

10. Kurrikula parashev që vlerësimi i nxënësve të bëhet rrëth 60% me vlerësimin me goje dhe aktivitete, dhe rrëth 40% me teste. A vlerësoheni në këtë mënyrë në?

- Asnjë lëndë mësimore
- Disa lëndë mësimore
- Shumicën e lëndëve mësimore
- Të gjitha lëndët mësimore

11. A dëshiron të shtosh edhe diçka për orarin mësimorë dhe kurrikulën? (të lutem shëno)

PËR TESTE VLERËSUESE

12. A ka ndodh ndonjëherë në shkollë të keni më shumë se një test brenda një dite?

- Po
- Jo
- Ndonjëherë

13. Sa është numri më i madh i testeve të mbajtura brenda një dite?

- 1
- 2
- 3
- Më shumë së 3

14. Sa ndihesh i/e stresuar në kohën e testeve?

- Aspak
- Pak
- Mesatarisht
- Shumë
- Jashtëzakonisht shumë

15. A dëshiron të shtosh edhe diçka për testet vlerësuese? (të lutem shëno)

PËR LËNDËT ZGJEDHORE

16. Kush e bën përgjedhjen e lëndës zgjedhore që ti vijon?

- Unë personalisht
- Nxënësit e klasës si grup
- Mësimdhënësit/Drejtori
- Nuk e di kush
- Dikush tjeter (të lutem shëno) _____.

17. Si vlerësoheni në lëndët zgjedhore?

- Vlerësimi me test/shkrim
- Vlerësimi me gojë
- Me aktivitete/pjesëmarrje aktive në orë
- Kombinimi i të gjithave më lartë
- Asnjëra më lartë

18. A dëshiron të shtosh edhe diçka për lëndët zgjedhore? (të lutem shëno)

PËR ORËT E KUJDESTARISË

19. A e mban orën e kujdestarisë?

- Po, gjithmonë
- Po, nganjëherë
- Rrallë
- Jo, asnjëherë

20. A e shihni të rëndësishme mbajtjen e saj?

- Po
- Jo
- Ndonjëherë

21. A mendoni që mbajtja e orës së kujdestarisë ju ofron hapësirën e mjaftueshme për të paraqitur shqetësimet, problemet apo ankesat e juaja?

- Po
- Në shumicën e rasteve
- Jo

22. A dëshiron të shtosh edhe diçka për orët e kujdestarisë? (të lutem shëno)

PYETËSOR PËR MËSIMDHËNËS

Mbi Grupin ROR (hulumtuesit):

Grupi Respect Our Right (ROR) është grupei i parë kombëtar në nivel vendi, i themeluar në vitin 2014, që bën monitorimin e zbatimit të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë dhe legjislacionit nacional, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.

Grupi ROR është i përbërë nga 24 fëmijë nga komunat e ndryshme te Kosovës, të moshave 14-17 vjeç, duke përfshirë fëmijë nga komunitetet dhe me aftësi të kufizuara dhe përkrahët nga Save the Children zyra në Kosovë (më tutje SCiK), dhe organizata joqeveritare Syri i Vizonit (më tutje SiV).

Përmes aktiviteteve lobuese, grupei ROR fuqizon zërin e fëmijëve në nivel vendi dhe avokon drejtpërsëdrejti tek institucionet përgjegjëse të cilat kanë për mandate mbrojtjen dhe qeverisjen me të drejtat e fëmijëve, për çështjet të cilat ndikojnë në jetën dhe mirëqenien e fëmijëve.

Qëllimi i studimit:

Grupi monitorues ROR nëpërmjet këtij pyetësori ka për qëllim të krijojë një pasqyrë të mbarëvajtjes së procesit mësimor që zbaton kurrikulat e reja mësimore dhe të çështjeve të cilat janë ngritur nga anëtarët e Grupit ROR si: përzgjedhja e lëndës zgjedhore, mbajtja e më shumë se një testi brenda ditës, mbajtja e orës së kujdestarisë apo rëndësia e kthimit të orës së kujdestarisë, marrja e informatave shtesë mbi kurrikulat.

Pas realizimit të këtij hulumtimi, ne si grup i fëmijëve ROR me ndihmën e dy organizatave SiV dhe SCiK do të përpilojmë një raport më të dalat nga pyetësorët ku më pas këto të dala do të ju prezantohen institucioneve përgjegjëse në nivel lokal dhe nacional.

Duke u përgjigjur në këtë pyetësor ju jeni duke kontribuar në gjetjen konkrete të ngecjeve në procesin e arsimit. Të dhënat e pyetësorit do të trajtohen si anonime dhe të fshehta dhe do të përdoren vetëm për qëllim të këtij pyetësori.

Ju faleminderit!

PAK PËR JU

1. Cilën/at lëndë i/e ligjëroni? _____
2. Me cilën/at klasa/gjenerata punoni? _____
3. Në cilën shkollë/institucion punoni? _____
4. Në cilin fshat apo qytet është shkolla/institucioni në të cilin punoni? _____
5. Sa është përafërsisht numri i nxënësve të cilëve u jepni mësim? _____
6. Sa vite përvojë pune keni në arsim? _____
7. Gjinia? Burrë
 Grua
 Tjetër (*ju lutem shënoni*) _____
8. Mosha: 20-24
 25-34
 35-44
 45-54
 55-64

PËR ORARIN MËSIMOR DHE KURRIKULEN

1. A mendoni që orari i ditës së hëne dhe të premte nxënësit duhet të jenë më pak të ngarkuar?
 - Po, mendoj që është e nevojshme
 - Po, do të ishte më pak stresuese
 - Jo, nuk është e nevojshme
2. Si jeni informuar për zbatimin e kurrikulave në shkollën ku punoni?
 - Nga MASHT
 - Nga drejtoria e shkollës
 - Nga Këshilli I mësimdhënësve
 - Nga Kolegët/mësimdhënësit
 - Nga nxënësit
 - Nga mediat elektronike dhe të shkruara, nga interneti dhe rrjetet sociale
 - Tjetër (*ju lutem shënoni*) _____

3. A jeni trajnuar mbi zbatimin e kurrikulës së re?

- Po
- Jo
- Tjetër (*ju lutem shënoni*) _____

4. A mendoni që keni nevojë për informata shtesë për kurrikulën?

- Po
- Pjesërisht
- Jo

5. Sa e vlerësoni të dobishme zbatimin e kurrikulave për nxënësit tuaj?

- Aspak
- Pak
- Mesatarisht
- Shumë
- Jashtëzakonisht shumë

6. A mendoni se është më efektive dhe më praktike për procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies zbatimi i kurrikulës së vitit 2016- 2021?

- Aspak
- Pak
- Mesatarisht
- Shumë
- Jashtëzakonisht shumë

7. Sa herë mbani orën mësimore duke shfrytëzuar burimet alternative, p.sh internetin?

- Asnjëherë
- Rrallë
- Ndonjëherë
- Shpesh
- Gjithmonë

8. A hasni në raste kur burimet e internetit bien ndesh me literature shkollore?

- Po, ndonjëherë
- Po, shpesh
- Jo

9. A vlerësoni nxënësit e juaj rrëth 60% me vlerësimin me gojë dhe aktivitet, ndërsa rrëth 40% me test?

- Në të gjitha klasat
- Në shumicën e klasave
- Në disa raste/ klasa por jo të gjitha
- Jo, në asnjë rast
- Tjetër (*ju lutem shënoni*) _____.

10. A dëshiron të shtoni edhe diçka për orarin mësimorë dhe kurrikulën? (*ju lutem shënoni*)

.

PËR TESTET VLERËSUESE

11. A e shihni të arsyeshme mbajtjen e më shumë se një testi vlerësues nga nxënësit tuaj brenda një dite?

- Po
- Jo
- Ndonjëherë

12. A koordinoheni me kolegët tuaj në mënyrë që nxënësit tuaj të mos kenë më shumë se një test brenda një ditë?

- Po
- Jo
- Ndonjëherë

13. A mendoni se mbajtja e më shumë se një testi shkakton ngarkesë psikike dhe stres tek nxënësit?

- Aspak
- Pak
- Mesatarisht
- Shumë
- Jashtëzakonisht shumë

14. A dëshiron të shtoni edhe diçka për testet vlerësuese? (*ju lutem shënoni*)

.

PËR LËNDËT ZGJEDHORE

15. Kush e bën përgjedhjen e lëndëve zgjedhore që ofrohen në shkollën ku ju punoni?

- MASHT
- Drejtoria Komunale e Arsimit
- Drejtori
- Këshilli i Mësimdhënësve
- Këshilli i Nxënësve
- Këshilli i Prindërve
- Nuk e di kush
- Dikush tjetër (*ju lutem shënoni*) _____.

16. A ju jepet nxënësve mundësia të marrin pjese në përgjedhjen e lëndëve zgjedhore që ofrohen ne shkolle?

- Po
- Jo

17. Nëse "po" cila formë/mënyrë është përdor për të marrë parasysh opinionet dhe interesimet e tyre gjatë përgjedhjes?

- Janë zhvilluar takime lidhur me këtë temë
- Është zhvilluar një anketë në nivel shkolle
- Është pyetur këshilli i nxënësve
- Tjetër (*ju lutem shënoni*) _____

18. Si vlerësohen nxënësit në lëndët zgjedhore?

- Vlerësimi me test/shkrim
- Vlerësimi me gojë
- Me aktivitete/pjesëmarrje aktive në orë
- Kombinimi i të gjithave më lartë
- Asnjëra më lartë

18. A dëshiron të shton si edhe diçka për lëndët zgjedhore? (*ju lutem shënoni*)

PËR ORËT E KUJDESTARISË

19. A jeni kujdestar klase?

- Po
- Jo

20. Nëse po, a e mbani orën e kujdestarisë?

- Po, gjithmonë
- Po, nganjëherë
- Rrallë
- Jo asnjëherë

21. Nëse jo, a mendoni se duhet të mbahet ora e kujdestarisë?

- Po
- Jo
- Ndonjëherë

22. A mendoni që mbajtja e orës së kujdestarisë ju ofron hapësirë të mjaftueshme për t'u njoftuar me problemet, shqetësimet, ankesat e nxënësve tuaj?

- Po
- Në shumicën e rasteve
- Jo

23. A dëshiron të shtoni edhe diçka për orët e kujdestarisë? (*ju lutem shënoni*)

.

PYETËSOR PËR DREJTORË

Mbi Grupin ROR:

Grupi Respect Our Right (ROR) është grupei i parë kombëtar në nivel vendi, i themeluar në vitin 2014, që bën monitorimin e zbatimit të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë dhe legjislacionit nacional, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.

Grupi ROR është i përbërë nga 24 fëmijë nga komunat e ndryshme te Kosovës, të moshave 14-17 vjeç, duke përfshirë fëmijë nga komunitetet dhe me aftësi të kufizuara dhe përkrahët nga Save the Children zyra në Kosovë (më tutje SCiK), dhe organizata joqeveritare Syri i Vizonit (më tutje SiV).

Përmes aktiviteteve lobuese, grupei ROR fuqizon zërin e fëmijëve në nivel vendi dhe avokon drejtpërsëdrejti tek institucionet përgjegjëse të cilat kanë për mandate mbrojtjen dhe qeverisjen me të drejtat e fëmijëve, për çështjet të cilat ndikojnë në jetën dhe mirëqenien e fëmijëve.

Qëllimi i Studimi:

Grupi monitorues ROR nëpërmjet këtij pyetësori ka për qëllim të krijojë një pasqyrë të mbarëvajtjes së procesit mësimor që zbaton kurrikulat e reja mësimore dhe të çështjeve të cilat janë ngritur nga anëtarët e Grupit ROR si: përzgjedhja e lëndës zgjedhore, mbajtja e më shumë se një testi brenda ditës, mbajtja e orës së kujdestarisë apo rëndësia e kthimit të orës së kujdestarisë, marrja e informatave shtesë mbi kurrikulat.

Pas realizimit të këtij hulumtimi, ne si grup i fëmijëve ROR me ndihmën e dy organizatave SiV dhe SCiK do të përpilojmë një raport më të dalurat nga pyetësorët ku më pas këto të dala do të ju prezantohen institucioneve përgjegjëse në nivel lokal dhe nacional.

Duke u përgjigjur në këtë pyetësor ju jeni duke kontribuar në gjetjen konkrete të ngecjeve në procesin e arsimit.

Të dhënat e pyetësorit do të trajtohen si anonime dhe të fshehta dhe do të përdoren vetëm për qëllim të këtij pyetësori

Ju faleminderit!

PAK PËR JU

1. Si quhet shkolla/institucioni që drejtoni? _____
2. Në cilin fshat apo qytet është shkolla/institucioni të cilin drejtoni? _____
3. Sa vite përvojë pune keni në menaxhimin në arsim? _____
4. Sa është numri i nxënësve në shkollë/institucionin që drejtoni? _____
5. Sa është numri i stafit arsimor dhe teknik që ju drejtoni? _____
Staf arsimor (*ju lutem shënoni numrin*) _____
Staf arsimor (*ju lutem shënoni numrin*) _____
6. Gjinia?
 Burrë
 Grua
 Tjetër (*ju lutem shënoni*) _____
7. Mosha:
 20-24
 25-34
 35-44
 45-54
 55-64

PËR ORARIN MËSIMOR DHE KURRIKULEN

1. A mendoni që oraret e ditës së hënë dhe të premte duhet të jenë më pak të ngarkuara për nxënësit?
 Po, mendoj që është e nevojshme
 Po, do të ishte më pak stresuese
 Jo, nuk është e nevojshme
2. Sa e vlerësoni të dobishme zbatimin e kurrikulave për nxënësit tuaj?
 Aspak
 Pak
 Mesatarisht
 Shumë
 Jashtëzakonisht shumë
3. A dëshiron të shtonи edhe diçka për orarin mësimor dhe kurrikulen? (*ju lutem shënoni*)

_____.

PËR TESTE VLERËSUESE

4. A mbajnë nxënësit e shkollës suaj më shumë së një test vlerësuese brenda një dite?

- Po
- Jo
- Ndonjëherë

5. A mendoni se mund të shkaktojë ngarkese psikike dhe stres tek nxënësit, mbajtja e më shumë se një testi brenda një dite?

- Aspak
- Pak
- Mesatarisht
- Shumë
- Jashtëzakonisht shumë

6. A kanë mësimdhënësit udhëzime të qarta për mënyrën e organizimit të testeve vlerësuese në mënyrë që nxënësit të mos ngarkohen psiqikisht dhe të performojnë sa më mirë?

- Po
- Jo
- Nuk e di

7. A dëshiron të shtonи edhe diçka për orarin mësimorë dhe kurrikulën? (*ju lutem shënoni*)

PËR LËNDËT ZGJEDHORE

8. Kush e bën përgjedhjen e lëndëve zgjedhore që ofrohen në shkollën ku ju drejtoni?

- MASHT
- Drejtoria Komunale e Arsimit
- Unë personalisht
- Këshilli i Mësimdhënësve
- Këshilli i Nxënësve
- Këshilli i Prindërve
- Nuk e di kush
- Dikush tjetër (*ju lutem shënoni*) _____.

9. Nëse lëndët zgjedhore nuk janë përgjedhur drejtëpërdrejt nga nxënësit, cila formë/mënyrë është përdor për të marrë parasysh opinionet dhe interesimet e tyre gjatë përgjedhjes?

- Janë zhvilluar takime lidhur me këtë temë
- Është zhvilluar një anketë në nivel shkolle
- Tjetër (*ju lutem shënoni*) _____.

10. Si vlerësohen nxënësit në lëndët zgjedhore?

- Vlerësimi me test/shkrim
- Vlerësimi me gojë
- Me aktivitete / pjesëmarrje aktive në orë
- Kombinimi i të gjithave më lartë
- Asnjëra më lartë
- Tjetër (*ju lutem shënoni*) _____.

11. A dëshiron të shtonи edhe diçka për lëndët zgjedhore? (*ju lutem shënoni*)

PËR ORËT E KUJDESTARISË

12. A e shihni të nevojshme mbajtjen e orëve të kujdestarisë?

- Po
- Jo
- Ndonjëherë

13. A janë të mjaftueshme orët e kujdestarisë që shkolla të marrë informacione lidhur me problemet, shqetësimet, ankesat e nxënësve tuaj?

- Po
- Në shumicën e rasteve
- Jo

14. A dëshiron të shtonи edhe diçka për orët e kujdestarisë? (*ju lutem shënoni*)

Syri i Vizionit

Isa Demaj 14
Pejë 30000, Kosovë
+383 (0) 39 423240
info@syriivizionit.org
www.syriivizionit.org



Syri i Vizionit

Save the Children në Kosovë

Rr.Gazmend Zajmi nr.1
Prishtinë, 10000 Kosovë
+383 (0) 38 23 26 91
scik@savethechildren.org
www.kosovo.savethechildren.net



Save the Children in Kosova/o

Respect our Right – ROR

www.ror-rks.net



Respect our Right - ROR